

Safet Emruli, PhD¹

UDC: 347.96/.99(492)
347.91/.95.047(492)

**SHQYRTIME TEORIKE MBI KUPTIMIN E
KUSHTETUTSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË NË PËRGJITHËSI**

**ТЕОРЕТСКИ ОСВРТИ ЗА РАЗБИРАЊЕТО НА УСТАВНОСТА
И ЗАКОНИТОСТА ВООПШТО**

**THEORETICAL REVIEWS FOR THE UNDERSTANDING OF
CONSTITUTIONALITY AND LEGALITY IN GENERAL**

Abstract

In the legal order, all acts issued by state bodies or non-state entities must be in accordance with the highest legal act. All acts issued in contradiction with the Constitution and the law would be unconstitutional acts, respectively illegal. An act that is not as per the Constitution is a violation of the constitutional order, i. e. it is an abnormal phenomenon, which violates its integrity and general social interests. Various systems of protection of constitutionality and legality have been constituted to prevent such unconstitutional phenomena. The struggle for constitutionality means the struggle for the objectification and democratization of the right and authorizations of the holders of public power, through the implementation of the Constitution, as the highest legal act. Constitutionality also means the fight against anarchy, the usurpation of power, as well as the fight for the constitutional protection of human and civil rights and freedoms, guaranteed by the Constitution and laws. The presence and observance of the principle of constitutionality influences the citizens to create a positive attitude towards the

¹ Ligjërues në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

observance of the constitution, but first of all the observance of the constitution must be done by the holders of state power themselves. The individual attitude towards the Constitution is determined by the attitude of the holder of state power towards the Constitution.

Gjyqësia kushtetuese paraqet aktorin kryesor të vendosjes dhe funksionimit harmonik të demokracisë së vërtetë, për arsye se ajo kujdeset që fryma e kushtetutës, ku janë të parapara rregullat e lojës së demokracisë pluraliste, sundimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të qytetarit, të respektohen dhe zbatohen në jetën reale. Gjyqësia kushtetuese, në fakt, paraqet segmentin kyç që garanton vitalitetin dhe efikasitetin e rendit juridik. Si e tillë, ajo lindi si pasojë e nevojave të jetës demokratike dhe jo duke qenë e paracaktuar me ndonjë dispozitë juridiko-kushtetuese.²

Gjyqësia kushtetuese është një aktivitet që mund të kryhet nga një gjykatë kushtetuese ose nga gjykatat e rregullta. Si në rastin e parë, kur gjyqësia kushtetuese jepet nga një organ i ndarë dhe i specializuar me kompetencë të posaçme në lëmin e drejtësisë kushtetuese, ashtu dhe në

² Zakonisht, si rast i parë që lidhet me lindjen e gjyqësisë kushtetuese merret rasti *Marbury vs. Madison* (1803), i zgjidhur nga Gjykata Supreme Amerikane në kohën e kryetarit të saj John Marshall. Në këtë rast, Gjykata Supreme theksoi se ndarja e pushteteve ashtu siç parashihet me Kushtetutën Amerikane kërkon që një prej pushteteve, ai gjyqësor, të jetë kontrollues i akteve të autoriteve tjera publike. Shih në Edward Samuel Corwin, *The Doctrine of Judicial Review, Its Legal and Historical Basis, and Other Essays* (Princeton University Press: Princeton, 1914), f. 78.

Në doktrinë, megjithatë, ka autorë të shumtë që fillet e gjyqësisë kushtetuese i lidhin me Britaninë e Madhe, qysh në vitin 1602, në rastin e mirënjohur *Dr. Bonham*. Në këtë rast për herë të parë është njohur kontrolli gjyqësor i akteve të parlamentit anglez. Por, në Britani kontrolli gjyqësor asnjëherë nuk arriti ta rrëzojë epërsinë e dukshme të parlamentit ndaj pushteteve tjera. Vetëm pas vitit 1998, kur doli Human Rights Act, kjo epërsi e parlamentit u zbeh, sepse tani Gjykata Supreme e Britanisë, e themeluar më 2005, i njehtë drejtën e vlerësimit gjyqësor të akteve të parlamentit, për të parë nëse ato akte legjislative janë në pajtim me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shih më shumë për këto në William E. Nelson, *Marbury v. Madison. The Origins and Legacy of Judicial Review* (University Press of Kansas: Kansas, 2000), f. 34-36; Helen Fenwick, Gavin Phillipson and Roger Masterman (eds.), *Judicial Reasoning Under the UK Human Rights Act* (Cambridge University Press: Cambridge, 2007), në veçanti pjesa e parë e kësaj përmbledhje, ku përfshihen shtjellimet e autorëve: Collin Warbrick, Roger Masterman, David Feldman, Aileen Kavanagh, Gavin Phillipson, Ian Leigh, dhe, së fundi, Sir David Keene. Të gjithë këta autorë trajtojnë ndryshimet radikale në sistemin britanik pas nxjerrjes së aktit të sipërcëkur të vitit 1998. Shih po ashtu në D. Nassimpian, "National Legal Tradition - United Kingdom". Në S. Galera (ed.), *Judicial Review. A Comparative Analysis Inside the European Legal System* (Council of Europe: Strasbourg, 2010), f. 157-172.

rastin e dytë, kur kjo jepet në kuadër të aktivitetit të përgjithshëm të gjyqësorit të rregullt, gjyqësia kushtetuese nënkupton një aktivitet specifik të dhënies së drejtësisë në një shoqëri të organizuar në shtet. Ai aktivitet specifik konsiston në kornizimin e sjelljes së shtetit me synim që ajo sjellje të zhvillohet brenda kuadrit kushtetues të përcaktuar me kushtetutë nacionale si dokument që përmban normat supreme të një shoqërie me të cilat rregullohen marrëdhëniet e pushtetit (horizontale dhe vertikale) si dhe marrëdhëniet tjera të natyrës socio-politike, kulturore dhe ekonomike, përfshirë këtu rolin dhe pozitën e individit në shoqëri dhe kundrejt pushtetit.³

Rendi juridik përbëhet prej elementeve të ndryshme, prej akteve juridike dhe normave të krijuara sipas tyre si dhe prej akteve materiale, sjelljeve të njerëzve. Të gjithë elementet e rendit juridik janë të radhitur në bazë të hierarkisë, ku në krye të piramidës gjendet kushtetuta, si akt më i lartë juridik i një vendi⁴. Në rendet e këtilla juridike të gjitha aktet që i nxjerrin, qoftë organet shtetërore apo subjektet joshtetërore, duhet të jenë në pajtim me aktin më të lartë juridik. Të gjitha aktet e nxjerra në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjin do të ishin akte kundërkushtetuese, respektivisht kundërligjore. Akti, i cili nuk është në pajtim me kushtetutën, paraqet shkelje të rendit kushtetues, pra është dukuri jo normale, e cila cenon tërësinë e saj dhe interesat e përgjithshme shoqërore. Për të penguar dukuritë e këtilla kundërkushtetuese janë konstituar sisteme të ndryshme të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Sistemet e tilla zakonisht ndahen në dy grupe. Grupi parë, është ai që bazohet në idenë fillestare të Hans Kelsen që nënkupton pasjen e një gjykate të veçantë kushtetuese, të ndarë nga gjykatat e rregullta, dhe njihet si sistemi i centralizuar i kontrollit kushtetues. Disa e quajnë sistemi kelsenian, apo evropian, i kontrollit kushtetues. Grupi i dytë,

³ Enver Hasani, Muhamet Brahim, Gjiqësia Kushtetuese, 2021, Prishtinë, f. 21.

⁴ Doktrinën mbi epërsinë e normës kushtetuese kundrejt normave tjera i pari e ka shtjelluar Hans Kelsen në veprën e tij monumentale mbi teorinë e pastër të së drejtës. Shih: Hans Kelsen, *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange LTD: Clark, New Jersey 2002, 2009), në veçanti f. 221-224. Ky libër, përmes të cilin Hans Kelsen njihet në komunitetin legal botëror, në fakt paraqet përpunim të ideve të tij nga libri i vitit 1911, i titulluar si *Hauptprobleme der Staatsrechtslehre* ("Teoria e Përgjithshme e Shtetit dhe e së Drejtës"). Shih versionin anglisht të këtij libri: Hans Kelsen, *General Theory of Law and State* (Harvard University Press: Cambridge, MA, 1945), në veçanti kapitujt X dhe XI, të cilët elaborojnë në themel dallimin në mes të normës bazike kushtetuese dhe normave tjera në kuadër të rendit juridik-kushtetues.

përfshin ato sisteme juridiko-kushtetuese, të cilat nuk kanë një gjykatë të veçantë kushtetuese, të ndarë nga gjykatat e rregullta, dhe në të cilat sisteme kontrolli kushtetues ushtrohet nga gjykatat e rregullta të të gjitha instancave, si pjesë e punës së tyre të ndarjes së drejtësisë së rregullt. Ky grupim i shteteve ka si shembull kryesisht SHBA-të, por njihet edhe në disa vende të Evropës (p.sh., vendet skandinave). Ky sistem, ndryshe njihet edhe si sistemi i decentralizuar i kontrollit kushtetues, në të cilin gjyqtarët e rregullt gjatë kohës së ushtrimit të punës së tyre, kanë të drejtën e moszbatimit të një ligji, të cilin ata vetë e vlerësojnë si në mospajtim me kushtetutën e vendit, por jo dhe shfuqizimin e tij. Kjo do të thotë se ligji, përkatësisht norma e cila cilësohet si në shpërputhje me kushtetutën, mbetet edhe më tutje në fuqi, për dallim nga sistemet e centralizuara, kelseniane, të kontrollit të kushtetutshmërisë.⁵ Kuptohet, një zhvillim si ky i sistemeve të mbrojtjes së kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, ka mund të ndodh vetëm pas paraqitjes së kushtetutave të para të shkruara, që do të thotë se vetëm me paraqitjen e kushtetutave të shkruara është shtruar nevoja e vënies në jetë të parimit, sipas të cilit çdo akt i pushtetit duhet të jetë i ligjshëm dhe se, çdo akt në kundërshtim me kushtetutën është jokushtetues, përkatësisht jo i ligjshëm⁶.

Lufta për kushtetutshmëri nënkupton luftën për objektivizimin dhe demokratizimin e të drejtës dhe të autorizimeve të bartësve të pushtetit publik, nëpërmjet zbatimit të kushtetutës, si akt juridik më i lartë. Kushtetutshmëria gjithashtu nënkupton edhe luftën kundër anarkisë, uzurpimit të pushtetit, si dhe luftën për mbrojtjen kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, të garantuara me kushtetutë dhe ligje. Prania dhe respektimi i parimit të kushtetutshmërisë ndikon te qytetarët që të krijojnë një qëndrim pozitiv ndaj respektimit të

⁵ Për zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese në përgjithësi. Shih: Stephen Holmes, "Constitutions and Constitutionalism". Në Michael Rosenfeld and Andras Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) f. 189- 216; Alec Stone Seet, "Constitutional Courts". Në Michael Rosenfeld and Andras Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, f. 816-830; R. C. Van Caengem, *An Historical Introduction to Western Constitutional Law* (Cambridge University Press: Cambridge, 1995), f. 244-295. Për elaborimet e para teorike të kësaj çështje, krahaso polëmikën në mes të Hans Kelsen dhe Karl Shmit, e zhvilluar në mes të dy luftërave botërore: Karl Smit, "Cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i Njegovi Kritičari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001), f. 211- 253; Hans Kelsen, "Ko Treba Da Bude Cuvar Ustava?". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka*, f. 255-296.

⁶ Dieter Grimm, "Types of Constitutions". Në Michael Rosenfeld & Andras Sajó (eds), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, f. 98-132;

kushtetutës, por para së gjithash respektimi i kushtetutës duhet të bëhet nga vetë bartësit e pushtetit shtetëror. Qëndrimi i individit ndaj kushtetutës, është i determinuar nga qëndrimi që ka bartësi i pushtetit shtetëror ndaj kushtetutës.

Ligjvënësi, i cili me veprimet e veta gjatë sjelljes së ligjeve nuk i respekton normat kushtetuese, si më të larta në një vend, nuk mund të thirret në respektimin e parimit të kushtetutshmërisë dhe të kërkojë përgjegjësi nga subjektet tjera në sistemin shoqëroro - politik, për shkak të mosrespektimit të kushtetutës. Cenimet e parimit të kushtetutshmërisë nga ana e ligjvënësit, janë shumë më të rrezikshme se cenimet që mund t'i bëjnë organet tjera, të cilët me akte normative të përgjithshme i rregullojnë raportet e tyre të bazuara në kushtetutë. Për shkak të natyrës dhe të rëndësisë që ka ligji, si akt juridik, që sipas fuqisë juridike vjen menjëherë pas kushtetutës, cenimi i kushtetutës me ligj nënkupton edhe krijimin e mundësive të panumërta të cenimit potencial të kushtetutës (në kohë dhe në hapësirë), në raport me numrin e pakufizuar të subjekteve ndaj të cilëve do të zbatohet ai ligj. Gjendjet e këtilla kundërkushtetuese, mundet vazhdimisht të përsëriten dhe të ripërtërihen, deri sa te jetë e vlefshme norma e tillë kundërkushtetuese, sepse të gjitha aktet individuale të krijuara në bazë të atij ligji do të duhej të zbatoheshin nga subjektet e së drejtës. Me këtë shkaktohen pasoja të panumërta, mes të cilave me e rëndë është krijimi i mosbesimit të qytetarëve në rendin juridiko- shoqëror. Në fakt, vetë nisja e gjyqësisë kushtetuese në botë, vështruar historikisht, ka filluar me pikë referimi kontrollin kushtetues të kushtetutshmërisë së normës ligjore, gjë që flet edhe polemika e sipërcituar në mes të Hans Kelsen dhe Karl Shmit. Në filllet e saj, keqkuptimet ndaj gjyqësisë kushtetuese kanë konsistuar në “absurditetin e gjykimit të normës ligjore”, apo, sic e ka thënë Karl Shmit, “si mund t'i bëhet gjyq një norme ligjore?”. Më një fjalë, në fillim është menduar se silogjizmi gjyqësor, përkatësisht subsumcioni i një gjende faktike, nën një norm ligjore, është i pamundur në rastet e gjyqësisë kushtetuese⁷. Më kalimin e kohës, jo vetëm që kjo u bë e mundur, por gjyqësia kushtetuese u shtri edhe përtej kontrollit kushtetues të normës ligjore duke kaluar në terrenin e të drejtave të njeriut: normat e gjëra, më plotë shumëkuptimi, abstarke dhe të përgjithësuara, të së drejtës kushtetuese

⁷ Karl Smit, “Cuvar Ustava”. Në Slobodan Samardzić (ed.), *Norma i Odluka*, f. 211-238.

gjetën mbrojtje institucionale nga gjykatat kushtetuese në mënyrë dhe me intensitet të njëjtë siç e gëzonin normat e rregullta juridike.⁸

Gjyqësia kushtetuese në Republikën e Maqedonisë ekziston gati qe 60 (gjashtëdhjetë) vite, e modeluar sipas sistemit të centralizuar kelsenian. Gjykata e pare Kushtetuese, si institucion i veçantë për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, është paraparë me Kushtetutën e vitit 1963 të ish Republikës Socialiste të Maqedonisë. Pothuajse, në formë të njëjtë, atë e parashikonte edhe Kushtetuta e vitit 1974 e ish Republikës Socialiste të Maqedonisë. Me pavarësimin e Republikës së Maqedonisë, në vitin 1991, si shtet i pavarur dhe demokratik, u miratua edhe Kushtetuta e re e Republikës së Maqedonisë, në të cilën Gjykata Kushtetuese, me kompetencat e saja parashihet në kreun e IV-të. Si rezultat i zhvillimeve të këtilla, Republika e Maqedonisë ka krijuar një përvojë disa dekadëshe të gjyqësisë kushtetuese, duke ndjekur teorinë dhe praktikën e modelit kelsenian të gjyqësisë kushtetuese.

Kushtetuta e vitit 1991 parashikon Gjykatën Kushtetuese me karakteristika dhe kompetenca të gjyqësisë kushtetuese bashkëkohore të centralizuar. Gjykata Kushtetuese paraqitet si roje e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe ka monopol në të drejten e ushtrimit të këtij funksioni mjaft të rëndësishëm të sigurimit të parimit të sundimit të së drejtës dhe ndërtimit të shtetit juridik. Në realizimin e kompetencës kushtetuese të saj, Gjykata Kushtetuese mbron dhe ruan hierarkinë e rendit juridik që shtrihet në gjithë tekstin e kushtetutës. Kur thuhet se Gjykata Kushtetuese ka monopol, atëherë nuk mendohet se organet dhe institucionet tjera përjashtohen nga interpretimet e Kushtetutës gjatë kohës së zbatimit të saj nga vetë këto organe e institucione. Njëjtë, si në secilin sistem të centralizuar të kontrollit kushtetues, edhe në rastin e Maqedonisë, fjala është për monopol në sensin që vetëm Gjykata Kushtetuese ka fjalën përfundimtare të interpretimit të Kushtetutës, duke përjashtuar çdo organ dhe institucion tjetër. Me një fjalë, monopoli këtu nënkupton që vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjithë, sepse vetëm Gjykata Kushtetuese ka të drejtën e interpretimit përfundimtar të tekstit të kushtetutës, interpretim i cili i detyron të gjithë.

⁸ Shih, Stephen Holmes, "Constitutions and Constitutionalism". Në Michael Rosenfeld & Andras Sajo (eds), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, f. 189-216; Alec Stone Sweet, "Constitutional Courts". Në Michael Rosenfeld & Andras Sajo (eds), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, f. 816-830.

Ekzistenca dhe funksionimi i shtetit të së drejtës bazohet në parimin e sundimit të së drejtës. Kushtetuta përbën aktin themelor të shtetit të së drejtës dhe prezumimin e realizimit të kushtetutshmërisë. Është fakt se ky dokument themelor, i cili garanton liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit dhe i cili parashih dhe përcakton organizimin e pushtetit shtetëror, ekziston në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, si shtete që do t'i kemi objekt të trajtimit në punimin tonë. Në rrethana të këtilla, duhet theksuar se liria e ligjvënësit në fushën normative - të ligjëbërjes, mund të realizohet vetëm në kuadër të parimeve të caktuara kushtetuese. Kjo liri e ligjvënësit është përcaktuar nga vlerat themelore që proklamohen dhe mbron kushtetuta, nga parimet kushtetuese. Kuptohet, se çdo shtet i ka specifikat e veta që ndikojnë në realizimin e funksionit të gjyqësisë kushtetuese, të cilat drejtpërdrejt janë të determinuara nga rrethanat politike, ekonomike, sociale etj., të vendit përkatës. Megjithatë, disa faktorë mund të merren si të përbashkët në këto vende: forca reale e shtetit (shtete të vogla, me ekonomi jo të zhvilluar, me problem të karakterit nacional, social etj.); ngecje në rrugën e integriteteve euroatlantike; jostabilitet politik dhe i sigurisë; jo pajtueshmëria midis realitetit dhe normativës; tendencat e politikës për cenim të pavarësisë së gjykatave kushtetuese dhe ndërhyrja në vendimet e saj etj. Këta faktorë që përmendim, do t'i trajtojmë në pjesët përkatëse të punimit tonë.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka respektimi i parimit të kushtetutshmërisë si një nga parimet dhe elementet kryesore të ndërtimit dhe funksionimit të shtetit të së drejtës, të cilin synojnë ta ndërtojnë vendet siç janë Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, mendojmë se është begatim i punimit shqyrtimi i saj në aspektin krahasues, në sistemet juridike-kushtetuese të vendeve në tranzicion, siç janë Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës, të cilat vende kanë disa karakteristika të përbashkëta, ashtu siç i kanë edhe specifikat e tyre të veçanta. Në të vërtetë, në të tre vendet ekziston sistemi i njëjtë i kontrollit kushtetues, sistem që ushtrohet nga ana e Gjykatës Kushtetuese, si organ i veçantë specifik gjyqësor. Për më tepër, tre vendet kanë rregullim shtetëror unitar; dhe, së fundi, tre vendet vijnë nga një sistem i kaluar socialist. Por, ekzistojnë dallime në mes tyre, si kur flitet për kompetencat që kanë gjykatat respektive kushtetuese. Gjithashtu, edhe kur është fjala për subjektet e inicimit të procedurës etj. Duhet veçuar edhe një dallim i theksuar, sepse në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kontrolli i

kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese ka një përvojë të gjatë, gati gjashtëdhjetëvjeçare, meqë ky vend ka qenë pjesë e ish Jugosllavisë, në të cilën kanë ekzistuar gjykatat kushtetuese nëpër republikë dhe ish krahina autonome (Kosovë e Vojvodinë), si dhe Gjykata Kushtetuese Federative. Kuptohet se, këtu duhet të bëjmë një dallim, sepse krejt ndryshe ka qenë kontrolli i kushtetutshmërisë në ish Jugosllavi prej atij që ekziston sot në këtë republikë dhe në ish republikat tjera Jugosllave. Në sistemin komunist jugosllav gjykata kushtetuese federative dhe ato nëpër republikë e krahina kanë mbrojtur një sistem të vlerave që nuk ka pasur të bëjë fare më konstitucionalizmin perëndimor modern. Në fakt, ato gjykata kushtetuese kanë qenë në shërbim të politikës ditore, përkatësisht në shërbim të arsyestimit të konceptit bazik mbi parimin e mosndarjes së pushtetit dhe rolin udhëheqës të partisë komuniste. Kjo vetvetiu e bën të papajtueshëm me konceptin e konstitucionalizmit modern perëndimor mbi ndarjen e pushteteve dhe sundimin e ligjit⁹. E njëjta gjendje ka ekzistuar në Poloni dhe ish Çekosllovakia, të cilat në dekadat e fundit të jetës së tyre, si sisteme komuniste, patën krijuar gjykatat e tyre kushtetuese¹⁰.

Në Republikën e Shqipërisë, për gjyqësinë kushtetuese mund të flasim vetëm pas ardhjes së demokracisë, dhe atë nga viti 1992, kur për herë të parë, me një ligj kushtetues, u parashikua themelimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta e vitit 1998 i krijoi Gjykatës Kushtetuese një pozitë më të qartë dhe më stabile, krahasuar me kohën pararendëse, e cila kohë u kritikua mjaft në literaturën e

⁹ Krahaso: Mirosal Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Power". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) f. 213-245; Për zhvillimet kushtetuese në ish Jugosllavi gjatë kësaj periudhe, shih më shumë në Jovan Gjorgjeviq, *E Drejta Kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mesimore i KSAK: Prishtinë, 1972) f. 75-114; Dr. Dimitrije Kulic, *Ustavno Sudstvo u Svetu* (NASA REC: Leskovac, 1972) f. 157-190.

¹⁰ Për rastin e Polonisë, shih në Leszek Lech Garlicki, "The Experience of the Polish Constitutional Court". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law Publisher: The Hague, 2010) f. 265-282; Për rastin e ish Cekosllovakisë, shih në Jiri Priban, "Judicial Power vs. Democratic Representation: The Culture of Constitutionlism and Human Rights in the Czech Legal System". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective*, f. 373-394.

jashtme mbi gjyqësinë kushtetuese: kjo periudhë u cilësua nga studijuesit e kohës si një periudhë jostabile dhe e ndikimit të madh të politikës shqiptare në punën e Gjykatës Kushtetuese.¹¹

I. 1. Dallimi i gjyqësisë kushtetuese nga format tjera të dhënies së drejtësisë

Pa marrë parasysh nëse ai realizohet nga një gjykatë e specializuar apo nga gjyqësori i rregullt, objekt i interpretimit në gjyqësinë kushtetuese është çdoherë norma kushtetuese. Në vijim të kësaj Kushtetuta duhet të kuptohet si tërësi, si një totalitet i teksteve juridike, praktikave, ligjeve dhe konventave (zakoneve), të cilat në një shoqëri të organizuar në shtet rregullojnë (normojnë) natyrën e pushtetit publik, mënyrën e ushtrimit të tij, si dhe rolin dhe pozitën e individit në këtë mes.¹²

Gjyqësia kushtetuese dhe gjyqësia e rregullt janë aktivitet i dhënies së drejtësisë, por ato kanë një varg dallimesh ndërmjet tyre. Ato dallime burojnë nga:

- objekti dhe qëllimi i interpretimit kushtetues, krahasuar me interpretimet që bëhen nga gjyqësori i rregullt;
- historia e zhvillimit të këtyre dy llojeve të aktivitetit publik në fushën e ndarjes (dhënies) së drejtësisë;
- natyra e interpretimit në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, krahasuar me gjyqësinë e rregullt; dhe, së fundi,
- organi që bën interpretimin si dhe për nga fuqia juridike e interpretimit kushtetues, krahasuar me interpretimin e kryer nga gjyqësori i rregullt.¹³

Në përpjekje për të sqaruar dallimin ndërmjet gjyqësisë kushtetuese dhe asaj të rregullt, është e nevojshme të merret në shqyrtim vetë esenca e debatit lidhur me këtë çështje, debat tanimë historik, në mes të Hans Kelsen (Hans Kelsen: 1881-1973) dhe Karl Shmit (Carl Schmitt: 1888-1985). Debat i është zhvilluar në mes të viteve njëzet të shekullit të kaluar. Thelbi i tij është si në vijim: sipas H. Kelsen, arkitektit ideor të gjyqësisë kushtetuese, gjyqësia kushtetuese duhet të jetë e ndarë nga gjyqësori i rregullt dhe duhet të ketë si detyrë

¹¹ Më shumë për këtë, shih në Herman Schwatz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post - Communist Europe*, f. 8, 222, 226, dhe 238. Ky autor ka bërë ndër studimet më serioze dhe më kritike të gjyqësisë kushtetuese të ish vendeve komuniste.

¹² Enver Hasani, Muhamet Brahimi, *Gjyqësia Kushtetuese*, 2021, Prishtinë, f. 24.

¹³ Ibidem.

primare kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Pra, sipas tij, subsumcioni (silogjizmi) gjyqësor në këtë lloj të gjyqësisë bëhet duke e krahasuar një normë më të ulët se kushtetuta me normën kushtetuese, pra duke e vënë normën më ulët se norma kushtetuese, përmes operacionit mendor të njohur si subsumcion (si-logjizëm) gjyqësor, nën normën kushtetuese si normë më e lartë. Në këtë lloj të ndarjes së drejtësisë, si fakt (kushtetues) që duhet vërtetuar është rrethana nëse një normë më e ulët se kushtetuta bie ndesh me një normë kushtetuese. Ndërkaq, sipas K. Shmit, ky lloj i gjyqësisë është absurd në vetvete, sepse nuk ka kuptim operacioni mendor i subsumcionit (silogjizmit) gjyqësor të një norme më të ulët me një normë tjetër më të lartë, por vetëm silogjizmi (nenvënia) i një norme juridike kundrejt një gjendje faktike. Kjo vlen për të gjitha procedurat: penale, civile dhe administrative. E thënë me fjalë të tjera, sipas tij nuk mund të ekzistojë gjykimi i një norme përmes një norme tjetër, por vetëm i një fakti kundrejt një norme.¹⁴

Rrjedha e zhvillimeve historike i ka dhënë të drejtë Hans Kelsenit. Kjo për arsye se, sikundër dihet, sot gjerësisht është i përhapur si profesion kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave të tjera më të ulëta se ligji, funksion ky primar i gjyqësisë kushtetuese dhe vetë arsyeja e lindjes së saj në të dy anët e Atlantikut. Juridiksioni tjetër i gjyqësisë kushtetuese, që ka të bëjë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, gjykimi i funksionarëve të lartë të pushtetit (impeachment-i), kontrolli kushtetues i aktivitetit të partive politike dhe kështu me radhë, kanë lindur më vonë.¹⁵

I. 1.a. Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në Kushtetutat e Republikës së Maqedonisë dhe të Republikës së Shqipërisë

Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është një nga parimet themelore të sistemit politik të Republikës së Maqedonisë dhe të Republikës së Shqipërisë. Nga dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së vitit 1991 dhe, nga dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë së vitit 1998, mund të vërehen elemente që kanë të bëjnë si me aspektin material ashtu edhe me aspektin formal të këtij

¹⁴ Ibidem, f. 26.

¹⁵ Ibidem, f. 26.

parimi, që do të thotë se ky parim trajtohet para së gjithash si kuptim juridik. Mirëpo, përveç karakterit juridik, parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, nuk ka dyshim se si nocion duhet parë edhe në kuptimin politik. Kjo nga fakti se kontrolli kushtetues në thelbin e vet përfshin edhe disa çështje, të cilat kanë patjetër edhe karakter politik, siç janë rastet e vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së programeve dhe statuteve të një partie politike, përfshirjen në shqyrtimin e përgjegjësisë së kryetarit të republikës, kontrollin kushtetues të procedurave të referendumeve, etj.¹⁶

Kushtetutat konstituojnë rendin kushtetues dhe përcaktojnë vlerat themelore, si dhe bazat e parimet e funksionimit të tyre. Bartësit e pushtetit, autorizimet e tyre i ushtrojnë në bazë të kushtetutës. Ky parim, në kuptimin e tij material, është forcuar veçanërisht me ekzistencën e pluralizmit politik dhe me parimin e ndarjes së pushteteve. Parimi i kushtetutshmërisë duhet domosdoshmërisht të jetë në funksion të realizimit, sigurimit dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, mes të cilave bien edhe të drejtat e nacionaliteteve ose pakicave kombëtare. Vendet që janë objekt shqyrtimi këtu janë me rëndë kushtetuese, të cilët funksionojnë në bazë të parimeve të kushtetutës, ku pushteti politik, bazën e funksionimit të tij, e ka të përcaktuar me dispozitat kushtetuese. Kështu, ta zëmë, neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thotë se “sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”.¹⁷ Kurse, sipas nenit 51 pika 1 të Kushtetutës së Maqedonisë, “ligjet në Republikën e Maqedonisë patjetër që duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën, kurse të gjitha aktet tjera në pajtueshmëri me ligjin dhe Kushtetutën”.¹⁸

Përveç këtyre parime, kushtetutshmëria nënkupton edhe pozitën kushtetuese të njeriut dhe qytetarit, e me të edhe të vetë karakterit kushtetues të lirive dhe të drejtave dhe të detyrimeve të qytetarit. Në tri

¹⁶ Shih më shumë në Venice Commission (ed.), *Models of Constitutional Jurisdiction* (Council of Europe Press: Strasbourg), në veçanti kapitujt II (“Control of Constitutionality of the Activities of the Supreme Organs of the State”), III (“Controversies Between the Central State and Regional or Other Subdivisions (Federal States, Cantons, Autonomous Regions, Provinces, Communities, etc.)”), VIII (“Jurisdiction on the Unconstitutionality of the Political Parties”).

¹⁷ *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë me praktikë gjyqësore* (Luarasi: Tiranë, 2004)

¹⁸ *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me amandamentet kushtetuese* (Gazeta Zyrtare e RM-së: Shkup, 2002).

kushtetutat që trajtohen këtu, ekziston një kapitull i gjatë dhe i elaboruar mbi të drejtat e njeriut, diçka që është bërë rutinë pas rënies së komunizmit në të gjitha vendet ish komuniste.¹⁹

Sa i përket parimit të ligjshmërisë, duhet theksuar se në më shumë dispozita kushtetuese theksohet se puna e organeve dhe institucioneve shtetërore bazohet në kushtetutë dhe ligj. Ligji si akt juridik, i cili në bazë të fuqisë juridike vjen menjëherë pas kushtetutës, bën konkretizimin dhe rregullimin e marrëdhënieve shoqërore të rregulluara më ligj, d.m.th marrëdhënieve shoqërore u jep karakter juridik. Si karakteristika më të rëndësishme të parimit të ligjshmërisë janë: parimi i shpalljes së ligjeve ose të akteve të tjera normative; ndalimi i efektit retroaktiv të ligjit; përcaktimi ligjor i veprave penale dhe i dënimeve; baza ligjore e akteve individuale; veprimi dhe masat e organeve të pushtetit shtetëror; baza ligjore e vendimeve gjyqësore; baza ligjore e veprimtarisë të subjekteve afariste si dhe baza ligjore e bartësve të funksioneve të pushtetit²⁰.

Përgjithësisht, parimi i kushtetutshmërisë në rendin juridik të Maqedonisë do të shprehej, *inter alia*, përmes e këtyre parimeve: epërsisë së kushtetutës; pozitës statusore kushtetuese; garantimit të kushtetutshmërisë; kushtetutshmërisë së fortë; përcaktimit si vlera kushtetuese të të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe ndarjen e pushtetit shtetëror në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, etj.

II. Përhapja globale e kontrollit kushtetues

Pas Luftës së Dytë Botërore pati një valë të madhe të krijimit të gjykatave kushtetuese. Gjykata të tilla u krijuan në Gjermani, Itali dhe Austri, më pas ato u përhapën edhe në Amerikën Latine e tutje. Qëllimi parësor i krijimit të këtyre gjykatave, në Gjermani dhe Itali por edhe në

¹⁹ Kushtetuta e parë që ka parashikuar një sistem të elaboruar për mbrotjen e të drejtave të njeriut ka qenë Kushtetuta e Vajmarit e vitit 1919, e cila në Kapitullin II të saj ka folur gjerësisht për të drejtat individuale të gjermanëve. Ky kapitull ka shërbyer si pretekst që në teori, një ndër autorët më të mëdhenj të shekullit që e lamë pas, Karl Shmit, ta quaj si “kushtetutë të dytë brenda Kushtetutës së Vajmarit”. Krahaso: Karl Smit, “Legalnost i Legitimnost”. Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka, Karl Smit i Njegovi Kriticari* f. 323-336. Për komente të përgjithshme rreth Kushtetutës së Vajmarit dhe vendit të Kapitulli II, shih më shumë në Arthur J. Jacobson and Benrhard Schlink (eds.), *Weimar. A Jurisprudence of Crisis* (University of California Press: Berkley, 2000)

²⁰ Vesela Mukovska - Çingo, *Ustavno Sudstvo*, f. 165

vendet tjera, kishte shkëputjen përfundimtare nga e kaluara naziste dhe fashiste dhe ndërtimi i standardeve të reja në fushën e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, të cilat do të ishin në përputhje me zhvillimet që ndodhen pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Këtu bëhej fjalë në veçanti për spastrimin e hesapeve me të kaluarën e hidhur nazi-fashiste të këtyre vendeve dhe me ndërtimin e mekanizmave mbrojtës për mospërsëritjen e të kaluarës. Në këtë drejtim flasin edhe vendimet e para të këtyre gjykatave: në Gjermani, ta zëmë, Gjykata në vitet '50 të shekullit të kaluar ndaloi veprimin e partive naziste dhe komuniste, kurse në Itali në kohën e njëjtë Gjykata bëri anulimin e shumë ligjeve nga koha fashiste që binin ndesh me vlerat e reja kushtetuese të sistemit Italian.²¹

Rënia e komunizmit përkoi me procesin e hartimit të kushtetutave të reja. Të gjitha shtetet e Evropës Lindore përfshinë në kushtetutat e tyre një organ me kompetencën e kontrollit kushtetues sipas modelit të centralizuar. Kjo ndodhi si pasojë e mosbesimit nga ana e secilit prej shteteve të dala nga regjimet autoritare për gjyqësorin. Secili prej këtyre shteteve zgjodhi të ndërtonte një model në të cilin kontrolli kushtetues i veprimeve të parlamentit do t'i ngarkohej një gjykate të specializuar, jashtë sistemit gjyqësor.²² Kjo nuk ishte e papritur, pasi i njëjti fenomen kishte ndodhur edhe në Evropën Jugore shumë vite më parë pas rënies së regjimit autoritar fashist në Greqi, Portugali dhe Spanjë. Në mënyrë të ngjashme, pas Luftës së Dytë Botërore, një proces i tillë ndodhi në Austri, Itali dhe Gjermani.²³

Aktualisht, mund të thuhet se kontrolli kushtetues është një fenomen global, mund të ketë diskutim për modelin, por jo për ekzistencën e tij.²⁴ Pra, procesi i krijimit të gjykatave kushtetuese tashmë ka marrë përmasa të natyrës globale. Ai tashmë ekziston edhe në organizma ndërkombëtar siç është rasti me KE dhe Bashkimi Evropian (BE): në rastin e parë, Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) shërben si një

²¹ Michael Gallagher, Michael Laver and Peter Mair, *Representative Government in Modern Europe*. f. 22 & 24.

²² Favoreu Louis, *Constitutional Review in Europe*. Në B. Bugaric, *Courts as Policy-Makers; Lessons from Translation, 2001*, Harvard Intl. LJ 1. Cituar sipas, Morina Visar, *Gjyqësi Kushtetuese*, 2013, f. 31.

²³ Ferejohn, J. & Pasquino, P., *Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice*. Publikuar në *Constitutional Justice East and West* by Wojciech Sadurski (ed.), Kluwer Law International ISBN 90-411-1883-7, 2002.

²⁴ Shih, Ginsburg Tom & Versteeg Mila, *Why Do Countries Adopt Constitutional Review?* Journal of Law, Economics and Organization, 2014, f. 1-52.

mekanizëm për të përcaktuar “kushtetutshmërinë” e kushtetutave nacionale, ligjeve dhe akteve tjera të vendeve të BE-së kundrejt rregullativës së saj, kurse GJEDNJ bën të njëjtën gjë sa i përket detyrimeve të shteteve anëtare lidhur me vënien në jetë të standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nëpër vendet e tyre.²⁵

Ky fenomen ka gjetur vend edhe në ato kombe, kultura ligjore e të cilave, për shumë kohë, mendohej se ishte diametralisht e kundërt me këtë proces, si p.sh. Franca, apo edhe në vende joperëndimore si Koreja\ e Jugut, India dhe Japonia, apo edhe në Izrael ku nuk gjendet një kushtetutë e shkruar.²⁶ Shembulli më i fundit i krijimit të organeve të specializuara që kërkojnë pushtetin ligjor për të deklaruar antikushtetuese aktet legjislativë dhe ekzekutive është GJKK.

Nëse marrim në shqyrtim peisazhin juridik të Evropës bashkëkohore, pa dyshim do të spikatë institucioni i gjykatës kushtetuese. Në një evolucion të gjatë që ka filluar pas Luftës së Parë Botërore dhe që arriti kulmin e vet pas rënies së komunizmit, në shumicën e vendeve evropiane janë krijuar këto gjykata të veçanta për të mbrojtur kushtetutat e tyre kombëtare. Në parim, Evropa e sotme është e lidhur në mënyrë të qartë me një “model të centralizuar” të vlerësimit të kushtetutshmërisë, ku vetëm një gjykatë ka autoritet për të interpretuar në mënyrë përfundimtare Kushtetutën, ndërsa në SHBA funksionon “modeli i decentralizuar”, ku të gjitha gjykatat janë të autorizuara për të vënë mënjanë legjislationin në qoftë se ai shkel Kushtetutën.²⁷ Kjo është arsyeja pse ekzistojnë dy sisteme të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, sistemi evropian apo kelsenian dhe sistemi amerikan. Në literaturë flitet edhe për një sistem tjetër, për sistemin e përzier apo **hibrid**. Në kuadër të secilit prej këtyre dy sistemeve ekzistojnë modele të nduarnduarta, aq shumë sa shpeshherë humb kuptimi i

²⁵ Shapiro, M., *Some Conditions for the Success of Constitutional Courts: Lessons from the U.S. Experience*. Publikuar në *Constitutional Justice East and West* by Wojciech Sadurski (ed.), f.37-59, Kluwer Law International ISBN 90-411-1883-7, 2002.

²⁶ The **European Commission for Democracy through Law** (Venice Commission), *Decisions of Constitutional Courts and Equivalent Bodies and Their Execution*. Report adopted by the Commission at its 46th plenary meeting, 2001. I arritshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-INF\(2001\)009-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-INF(2001)009-e).

²⁷ Ferreres Victor, *The consequences of centralizing constitutional review in a special court. Some thoughts on judicial activism*. Sela (Seminario en Latinoamérica de Teoría Constitucional y Política) Papers, Paper 39, 2004.

ndarjes së gjyqësisë kushtetuese sipas sistemeve. Kjo është arsyeja që aktualisht ekziston një tendencë e shndërrimit të modeleve të gjyqësisë kushtetuese në sisteme dhe fshirjen e dallimeve konkrete sipas të cilave disa vende modelohen.²⁸

III. Pozita kushtetuese - juridike e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë përcaktohet se “Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë është organ i Republikës i cili e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë”²⁹. Gjykata Kushtetuese paraqitet si institucion tejet i rëndësishëm kushtetues, me një pozitë të veçantë kushtetuese, që e përcakton drejtpërsëdrejti kushtetuta, e cila përcakton krahas pozitës edhe kompetencat e saj. Duke e trajtuar atë si kategori kushtetuese, ajo përcaktohet vetëm me kushtetutë, d.m.th. jo edhe me ligj ose akt nënligjor. E vetmja çështje që nuk rregullohet me kushtetutë e as me ligj është çështja e mënyrës së punës dhe procedurave të saj. Rregullimi i materies që parashihet me aktin e brendshëm të gjykatës, nuk mund t’i tejkalojë kornizat kushtetuese të pozitës që ajo ka. Lejimi që disa punë t’i rregullojë në mënyrë të pavarur Gjykata Kushtetuese me akt të vetin, e forcon pozitën e saj në sistemin e ndarjes së pushteteve, veçanërisht ndaj pushtetit ligjvënës.³⁰ Madje ka edhe pikëpamje tjera se rregullimi i këtillë i punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, ka mundësi që ta bëjë atë tejet komode në ecurinë e drejtësisë kushtetuese. Duke pasur parasysh se kjo Rregullore e Gjykatës Kushtetuese është nxjerrë në vitin 1992, shumë shpejt pasi Republika e Maqedonisë doli nga një sistem dhe një mentalitet socialist dhe, duke pasur parasysh ndryshimet kushtetuese që ndodhen si rezultat i Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001, jam i mendimit se është koha për nxjerrjen e një ligji për punën e Gjykatës Kushtetuese, i cili do të duhej t’i ngërthente në vetvete të gjitha ndryshimet kushtetuese, ku do të duhej ta përmbante edhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës edhe në gjuhen shqipe.

²⁸ Për një shqyrtim të detajuar dhe të thellë të kësaj problematike, shih më shumë në Justin O’ Frosini & Lucio Pegoraro (eds.), *La giustizia costituzionale nel XXI secolo* CLUEB: BOLOGNA; Lucio Pegoraro, *SWEds* (G. Giappichelli Editore: Torino), 2010.

²⁹ Sih nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

³⁰ Shih Vesela Mukovska Çingo, *Ustavno Sudstvo*, Shkup 2002, f. 227-228

Pavarësia e Gjykatës kushtetuese shihet në atë se ajo funksionin e vet e ushtron vetëm në bazë të kushtetutës. Pra, në punën e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë të drejtë të ndikojnë as Kuvendi Republikan e as ndonjë organ tjetër shtetëror, sepse Gjykata Kushtetuese veprimtarinë e vet e ushtron në mënyrë të pavarur, pa ndikimin e asnjë organi shtetëror ose joshtetëror tjetër.

Institucionalisht, Gjykata Kushtetuese, në një kuptim të veçantë, përfshihet në sferën e pushtetit gjyqësor, por, me një dualizëm në rolin dhe pozitën që ka. Ajo nuk është institucion klasik gjyqësor, edhe përkundër ekzistencës së disa elementeve të gjyqësisë klasike. Gjykata Kushtetuese ka edhe dimension më të gjërë politik, por megjithatë nuk është dhe nuk paraqitet si organ apo institucion politik në kuptimin e vërtetë të saj. Duke pasur parasysh karakterin specifik të saj, Gjykata Kushtetuese paraqitet si gjykatë kushtetuese - juridike e veçantë dhe si institucion politik. Karakteri dualist, nuk është cilësi vetëm e Gjykatës Kushtetuese të R. Maqedonisë, por edhe e gjykatave kushtetuese të vendeve tjera, pra edhe e asaj të Republikës së Shqipërisë.

Gjykata kushtetuese, para së gjithash, është organ i jurisprudencës, në bazë të vetë emrit që i përcakton kushtetuta. Si gjykatë, funksion themelor ajo ka mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të sistemit. Karakteri mbrojtës i këtij funksioni, është element i theksuar klasik gjyqësor, i cili, me të vërtetë gjykatës i jep karakterin dhe pozitën e një institucioni të veçantë gjyqësor në sistem. Funksioni mbrojtës, të cilin e realizon përmes zhvillimit të kontestit kushtetues - juridik, në një procedurë të caktuar paraprake dhe me sjelljen e vendimit të vet, janë gjithashtu elemente të natyrës dhe karakterit të saj gjyqësor.³¹ Gjykata Kushtetuese, nuk krijon të drejtën dhe nuk përcakton çka është e drejta, por, konstaton çka nuk është e drejtë. Ajo nuk shkruan norma origjinale, por i shqyrton, i vlerëson dhe vendos në mënyrë përfundimtare se normat përkatëse dhe marrëdhëniet e caktuara janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, respektivisht me ligjet.

Sa i përket karakterit të saj si organ apo institucion politik, ajo duhet të mbajë përgjegjësi edhe për raportet politike të marrëdhënieve, të kushteve dhe rrethanave nën të cilat sillen vendimet e gjykatës. Për shkak të këtyre arsyeve, por edhe të çështjeve që bien në kompetencë të

³¹ Po aty, f. 229

saj, ajo gjithashtu, në shkallë të njëjtë, paraqet organ politik, respektivisht institucion politik sui generis.³²

Gjykata Kushtetuese duhet në thelb të mbrojë rendin juridik objektiv të shtetit. Nga pozita që ka në Kushtetutën e RM-së, ajo nuk nënkupton se duhet ta mbrojë vetëm kushtetutën, por, duhet ta ruajë edhe kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e sistemit. Në këtë rast, paraqitet dilema se sa kjo mbrojtje e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë duhet të nisët vetëm nga aspekti i kushtetutës së shkruar apo nga e gjithë ajo që del nga kuptimi i së drejtës kushtetuese në një shtet. Nga dilema e parashtruar se Gjykata Kushtetuese është vetëm ruajtës i kushtetutës, që zakonisht nënkuptohet si një qëndrim klasik, apo se është ruajtës i rendit juridik objektiv në shtet, do të përcaktohem për interpretimin më të gjërë të saj. Funkcioni themelor i saj është që ta ruajë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në tërësinë e rendit kushtetues dhe juridik të Republikës së Maqedonisë. Objektin e vetë të mbrojtjes, kushtetuta nuk e kufizon vetëm në akte ose veprime të caktuara, apo vetëm në subjekte të caktuara. Përkundrazi, ajo e ka parasysh tërësinë e sistemit dhe rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, por nga aspekti i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.³³

Recommendations:

1. The Constitutional Court is an institution of the constitutional order of the Republic of North Macedonia. Its main competence is the protection of constitutionality and legality. It is the highest institution of the constitutional order for the protection of constitutionality and legality. As such it is a sui generis institution and should be independent of the holders of power and authority in society.

2. The Constitution of the Republic of North Macedonia from the formal-legal aspect provides the court with a high degree of functional independence. However, the high degree of disharmony between the normative and factual aspects of the country's society has made itself felt here as well. The Constitutional Court, to a certain extent, depends on the holders of power and authority in society.

3. The regulation of the method of work and the procedures before the Constitutional Court, with

³² Po aty, f. 229-230

³³ Po aty, f. 230

Rules of Procedure, at first sight, largely make the court independent of the holders of power and authority in society. However, this is not the case. The regulation modulates the method of work and procedures before the court, but not the material and immaterial status of judges and professional service officers which should correspond to their social position as members of the staff of the Constitutional Court as the highest and most responsible instance. for the protection of constitutionality and legality in the Republic. The regulation also modulates other issues related to the work and procedure before the Constitutional Court or arranges them by regulation, although this must be done by law, with a special law for the Constitutional Court. The eventual adoption of a special Law on the Constitutional Court does not exclude the need for detailed regulation of the manner of work and procedures before the court with Rules. Hence, after the eventual adoption of the law, the court must adopt the Rules of Procedure.

4. The Constitutional Court of the Republic of North Macedonia, as a defender of the rule of law and its special goals, such as - raising public awareness of the work of the Constitutional Court, focusing the public interest in its work; improve data collection through continuous monitoring and analysis of the work of the Constitutional Court and increase public knowledge of accessible mechanisms for protecting the constitutionality and legality of laws and legal acts, as well as human rights and freedoms. guaranteed by the Constitution before the Constitutional Court.

Recensentë:

Prof. Dr. Mersim Maksuti

Prof. Dr. Jusuf Zendeli

Literatura e shfrytëzuar dhe e konsultuar:

Enver Hasani, Muhamet Brahim, Gjyqësia Kushtetuese, 2021, Prishtinë

Luan Omari- Aurela Anastasi, “E drejta Kushtetuese”, Shtëpia Botuese “ABC”, Tiranë, 2010

Bajram Pollozhani, “Një shqyrtim komparativ kushtetues- juridik për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë”, Universitas, Viti V, Nr.8, Tetovë, Tetor 2006

Kurtesh Saliu, “E drejta Kushtetuese”, (Libri I), Prishtinë, 1998

- Krisatq Traja, “Drejtësia Kushtetuese”, Shtëpia Botuese “Luarasi”, Tiranë, 2000
- Sokol Sadushi, “Kontrolli Kushtetues”, Shtëpia Botuese BOTIM-PEX, Tiranë, 2004
- Kranar Loloçi, “Kushtetuta dhe nevoja për një mentalitet të ri”, “Horizont”, Tiranë, 2002
- Vesela Mukovska- Çingo, “Ustavno sudstvo”, (Teorija i praktika), Shkup, 2002
- Osman Kadriu, “Rregullimi kushtetues i Maqedonisë”, Shkup 2006
- Savo Klimovski, “Ustaven i politički sistem”, Prosvetno delo, Skopje, 1997
- Svetomor Shkariç, “Sporedbeno i makedonsko ustavno pravo”, Matica, Skopje, 2002
- Svetomor Shkariç, “Ustavno pravo” (prva kniga), Skopje, 1994
- Svetomor Shkariç, “Ustavno pravo” (vtora kniga), Union –Trade, Skopje, 1995
- Dimitar Kuliç, “Ustavno sudstvo u svetu”, Beograd-Zajeçar, 1982
- William E. Nelson, *Marbury v. Madison, The Origins and Legacy of Judicial Review* (University Press of Kansas: Kansas, 2000)
- Helen Fenwick, Gavin Phillipson and Roger Masterman (eds.), *Judicial Reasoning Under the UK Human Rights Act* (Cambridge University Press: Cambridge, 2007),
- Hans Kelsen, *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange LTD: Clark, New Jersey 2002,
- Hans Kelsen, *General Theory of Law and State* (Harvard University Press: Cambridge, MA, 1945)
- Michael Rosenfeld and Andras Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i Njegovi Kritičari* (“Filip Visnjic”: Beograd, 2001),
- Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post – Communist Countries* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 2002, Dr. Dimitrije Kulic, *Ustavno Sudstvo u Svetu* (NASA REC: Leskovac , 1972)
- Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law Publisher: The Hague, 2010)
- Adam Czarnota, Martin Krygier and Wojciech Sadurski (eds.), *Rethinking the Rule of Law After Communism* (CEU Press: Budapest, 2005)